

nr. 6, qershor 2009

gap

monitor

i vendimeve të Qeverisë së Kosovës

E enjte

e premte

e shtunë

e diel

3

4

5

6

9

10

11

12

13

16

17

18

19

20

shtator 2009

Hekurishtet duhet të largohen pas 20 shtatorit

- Rritet numri i projektligjeve në Strategjinë Legjislative 2009, përkundër ngecjeve në zbatimin e saj
- Hapet rruga për dhënie me koncesion të Aeroportit të Prishtinës
- Regjistrimi i popullatës dy vjet larg
- Ndahen mjetet për pagesën fillestare të anëtarësisë në Bankën Botërore



## Tungjatjeta!

Qeveria e Kosovës e ka përmbyllur gjashtëmuajorin e parë të qeverisjes në vitin 2009.

Në muajin shkurt, Qeveria ka miratuar Planin e Punës për vitin 2009, i cili i përfshin aktivitetet njëvjeçare të Zyrës së Kryeministrit dhe të gjitha Ministrive. Sipas këtij plani, Qeveria e Kosovës, për çdo tre muaj, do ta rishikojë zbatimin e planit të punës së secilës Ministri. Një gjë e tillë nuk ka ndodhur në këta gjashtë muaj të qeverisjes. Plani i Punës së Qeverisë për 2009 asnjëherë nuk është rishikuar në mbledhjet e Qeverisë.

Edhe këtë muaj, Qeveria e Kosovës ka mbajtur katër mbledhje në të cilat ka marrë 31 vendime.

Listës së 115 Projektligjeve në Strategjinë Legjislative të Qeverisë për 2009 i janë shtuar edhe katër Projektligje. Qeveria ka miratuar edhe tri Projektligje që kanë qenë të parapara me strategjinë legjislative, si dhe ka miratuar katër strategji dhe plane të veprimit.

Edhe në këtë periudhë, Qeveria ka vazhduar me marrjen e vendimeve për mbështetje financiare të kategorive të dala nga lufta (UÇK), ku me dy vendime

janë ndarë 208.500 euro.

Për këto dhe vendime të tjera, ju ftojmë ta lexoni numrin e gjashtë të GAP Monitor.

Kurse, për zbatueshmërinë e vendimeve të pesë muajve të kaluar, mund ta lexoni "Matricën e Zbatueshmërisë së Vendimeve të Qeverisë".

Lexim të këndshëm!

## Përmbajtja

- 3 90 ditë për t'i pastruar rrugët magjistrale nga hekurishtet
- 4 Qeveria rrit numrin e Projektligjeve në Strategjinë Legjislative 2009, edhe pse nuk ka mundur ta zbatojë atë në afatin a paraparë
- 5 Hapet rruga për dhënien me koncesion të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës
- 6 Qeveria i bie pishman – lejon ndërtimin e "Spitalit të Dalladaku"
- 7 Sa banorë i ka Kosova? – Përgjigjja është dy vjet larg
- 8 Ndahen mjetet për pagesën fillestare të anëtarësisë në Bankën Botërore
- 9 Bëhet hapi i parë në vënien e bazës ligjore për luftimin e krimit kibernetik
- 10 Themelohet Zyra për Çështjen e Trashëgimisë së TMK-së
- 11 Miratohen edhe katër strategji
- 15 Dërgohen në Kuvend emrat e kandidatëve për anëtarë të Bordit të ART-së
- 16 Qeveria subvencionon korrjeshirjet me 500.000€
- 17 Qeveria i kërkon Kuvendit që Zhuri të shpallet zonë me interes të veçantë ekonomik
- 18 Formohet Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve të Shkaktuara nga Breshri në Gjilan
- 18 Zyra për Komunitete bëhet pjesë e programit të USAID për ndryshime pozitive
- 19 Miratohet Projektligji për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit
- 20 Formohet Bordi Këshillëdhënës për Promovimin e Investimeve
- 21 Qeveria përkrah një simpozium për ndriçimin e aktiviteteve të lëvizjes çlirimtare
- 21 Miratohet Projektligji për Mbrojtjen e Topografisë së Qarqeve të Integruara
- 22 Emërohet Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike
- 22 Qeveria ndan edhe 452.681€ nga fondi rezervë
- 24 Përmbledhja



## 90 ditë për t'i pastruar rrugët magjistrale nga hekurishtet

Sipas një vendimi të Qeverisë së Kosovës, të marrë në mbledhjen e 69-të, më 19 qershor 2009, të gjitha pikat e grumbullimit të hekurishteve duhet që të largohen 1 kilometër larg rrugëve magjistrale.

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, Ministria e Pushtetit Lokal dhe Ministria e Punëve të Brendshme. Pikat e grumbullimit të hekurishteve janë trajtuar në bazë të Ligjit për Mbeturina dhe Urdhëresës Administrative të MMPH-së për administrimin e automjeteve të hedhura dhe mbeturinave të tyre, nr. 02/2009. Mirëpo, asnjëra nga këto dy akte ligjore nuk e parasheh largësinë, respektivisht hapësirën, ku duhet të vendosen këto pika

grumbulluese të hekurishteve. Gjatë vitit 2008, Pal Lekaj, Kryetar i Komunës së Gjakovës,

është zbatuar nga inspektorët komunalë, sipas të cilëve një vendim i tillë për largimin e

Pas marrjes së këtij vendimi, MMPH-ja i ka njoftuar me shkrim 144 operatorë për grumbullimin e hekurishteve në mbarë Kosovën se nëse deri më 20 shtator nuk i largojnë hekurishtet 1 km nga rrugët magjistrale, ata do të gjobiten, ose do t'u konfiskohen ato. Legjislacioni që trajton çështjen e hekurishteve nuk e parasheh hapësirën për vendosjen e hekurishteve.

kishte urdhëruar që të largohen të gjitha pikat e grumbullimit të hekurishteve që ndodhen në brendi të qytetit, me arsyetimin se po e prishnin pamjen e qytetit. Mirëpo, ky vendim nuk

hekurishteve nuk ka bazë ligjore, pasi këto pika grumbulluese kanë leje mjedisore nga MMPH-ja dhe leje biznesi nga MTI-ja.

Ky vakum ligjor i mospërcaktimit të lokacionit

për vendosjen e pikave grumbulluese është vendosur të plotësohet me vendim ekzekutiv të Kryeministrit.

Vendimi nr. 03/69 kërkon që këto pika të largohen nga rrugët magjistrale në një largësi prej 1 km. Pas marrjes së këtij vendimi, inspektorët e MMPH-së janë mobilizuar dhe u kanë dërguar njoftimin me shkrim 144 operatorëve të regjistruar për grumbullimin e hekurishteve. Inspektorët e MMPH-së i kanë njoftuar këta operatorë me vendimin e Kryeministrit, afatin

kohor deri kur duhet t'i largojnë deponitë e tyre, si dhe masat ndëshkuese në rast se nuk do të zbatohet vendimi brenda 90 ditësh.

Sipas listës së inspektorëve të MMPH-së, të cilët i kanë njoftuar operatorët në 13 komuna të Kosovës, Komuna e Ferizajit ka më së shumti operatorë të hekurishteve, gjithsej 30, pas saj vijën Lipjani me 26, Drenasi me 25, Vushtrria me 13, Fushë Kosova me 11, Prishtina me 9, Mitrovica, Vitia dhe Shtimja me nga 6, Gjilani dhe Podujeva me

nga 4 dhe Obiliqi me 1. Njoftimet nuk janë bërë ende edhe për disa operatorë në komunat Gjakovë, Prizren, etj.

Nëse nuk zbatohet vendimi i Qeverisë për largimin e pikave grumbulluese të hekurishteve, operatorët mund të ndëshkohen sipas neneve 47 dhe 48 të Ligjit për Mbeturinat, të cilët parashohin dënime në mjete financiare prej 500 deri 100.000 euro, ose konfiskim të hekurishteve.

## Qeveria rrit numrin e Projektligjeve në Strategjinë Legjislative 2009, edhe pse nuk ka mundur ta zbatojë atë në afatin a paraparë

Në dhjetor 2008, Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë Legjislative për 2009, e cila fillimisht përmbante 112 Projektligje.

Kësaj liste të Projektligjeve iu shtua edhe nga një Projektligj në muajt shkurt, mars dhe prill. Në muajin qershor, Qeveria i shtoi kësaj liste edhe pesë Projektligje

për Teatër, Projektligji për Marrëveshjet Ndërkombëtare, Projektligji për Zbatimin e Sanksioneve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Projektligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Projektligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit Penal për të Mitur.

Tash që kanë kaluar gjashtë

parapara në Strategjinë Legjislative, pa i llogaritur katër Projektligjet që i janë shtuar në qershor, për muajt janar-qershor 2009 është paraparë që të miratohen 72 Projektligje. Deri në fund të qershorit, prej këtyre 72 Projektligjeve Qeveria ka miratuar vetëm 27, ose 37.5 për qind të tyre. Për pjesën e dytë të vitit kanë mbetur të miratohen edhe 93 Projektligje.

Nga praktikat e gjertanishme, asnjë Qeveri nuk e ka respektuar në tërësi Strategjinë Legjislative në vitet paraprake, duke mos i miratuar Projektligjet e parapara në Strategji dhe duke mos i respektuar afatet kohore.

Siç shihet, as kjo Qeveri nuk do të mund ta zbatojë në tërësi Strategjinë e saj të miratuar në dhjetor, kurse në anën tjetër vazhdon të marrë vendime me të cilat këtë Strategji e rëndon edhe më tepër me Projektligje.

Qeveria e Kosovës, me tri vendime të ndryshme, i ka shtuar edhe pesë Projektligje në Strategjinë Legjislative 2009. Qeveria vazhdon të shtojë Projektligje në këtë Strategji, kurse në anën tjetër nuk është duke i respektuar afatet kohore për miratim të Projektligjeve, ashtu siç janë të parapara në Strategji.

të reja, duke ngritur numrin e tyre në 120.

Projektligjet e shtuara në Strategjinë Legjislative janë: Projektligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit

muaj të vitit 2009, vlen t'ia hedhim një sy performansës së Qeverisë për këtë periudhë sa i përket miratimit të Projektligjeve - të cilat i ka zotuar me Strategjinë e saj Legjislative për vitin 2009.

Nga 115 Projektligjet e



## Hapet rruga për dhënien me koncesion të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës

Në mbledhjen e saj të 68-të, mbajtur më 12 qershor të vitit 2009, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim ta miratojë rekomandimin e propozuar nga Komiteti Ndërmator për zbatimin e Partneritetit Publiko-Privat në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës.

terminalin e ri me 25 mijë metra katrorë, zhvendosjen e pajisjeve të radarit, platformën e re për pozicion të parkimit, platformën e re për marrjen dhe zbritjen e pasagjerëve, parkingun e ri, vendqëndrime të reja për autobusë dhe taksi, pozitë të re për hyrje në aeroport, si dhe sistemin e ri për trajtimin e ujërave.

85.1 milionë euro, ndërkaq benefiti i shtetit të Kosovës 400.1 milionë euro.

Ligji për Partneritetin Publiko-Privat është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në qershor.

Me këtë Ligj, Qeveria ka mundësi t'i japë ndërmarrjet publike me koncesion deri në një afat prej 40 vjetësh, por edhe institucionet në të gjithë sektorët duke filluar nga projektet aktuale të infrastrukturës e deri tek pronësia në shkolla, spitale dhe borxhe, nëse për këtë ka interesim të sektorit privat.

Ligji i parasheh sektorët të cilët do të jenë të hapur për investimet private dhe i autorizon Ministrinë përkatëse që t'i identifikojnë projektet të cilat do të mund t'i tërhiqnin investitorët e ardhshëm. Në Ligj thuhet se ai është hartuar me qëllim të përcaktimit të kushteve me të cilat palët private mund të marrin koncesione, ose ndonjë mënyrë tjetër, për shfrytëzimin ose eksploatimin e infrastrukturës publike, ndërmarrjeve publike dhe burimeve publike. Me këtë

Sipas përllogaritjeve, pas dhënies së kësaj ndërmarrjeje me koncesion, Buxheti i Kosovës do të ketë dyfish më tepër të hyra nga ANP-ja sesa që ka tash.

Komiteti Drejtues Ndërmator për analizimin e arsyeshmërinë së dhënies me koncesion të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës dhe për përgatitjen dhe zbatimin e Partneritetit Publiko-Privat është themeluar në qershor të vitit të kaluar, me vendimin e Qeverisë nr. 14/24.

Sipas Qeverisë së Kosovës, Aeroporti i Prishtinës do t'i tërheqë rreth 80 milionë euro investime deri në vitin 2012. Sipas vendimit të Qeverisë, projekti për involvimin e partneritetit publiko-privat përfshin

Sipas Qeverisë së Republikës së Kosovës, rekomandimi është bazuar në studimin e fizibilitetit të përgatitur nga konsorciumi i kompanive amerikane dhe holandeze.

Sipas përllogaritjeve që ka bërë kjo kompani, pas dhënies së kësaj ndërmarrjeje me koncesion Buxheti i Kosovës do të ketë dyfish më tepër të hyra nga ANP-ja sesa që ka tash. Më saktësisht, sipas të dhënave të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, plani i investimeve parallogaritet të jetë

Ligj, kapitali privat mund të futet në të gjithë sektorët e ekonomisë si transporti, hekurudhat, rrugët; prodhimi i energjisë elektrike dhe i nxehtësisë; prodhimi, distribuimi, trajtimi, mbledhja dhe administrimi i ujit, ujërave të zeza, drenazhës, ujitjes, kanaleve, pendëve; mbledhja, transferimi, procedimi dhe administrimi i mbeturinave të ngurta dhe riciklimi; arsimit, sporti, telekomunikacioni, shëndetësia, turizmi dhe kultura, pastaj burgjet, parqet industriale, strehimi publik,

gjegjëse, mirëpo në asnjë rast nuk duhet të jetë më shumë se dyzet (40) vjet nga data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes.

Po ashtu, me këtë Ligj, partnerët privatë përkohësisht do të mund ta marrin pronësinë mbi Objektivin e Infrastrukturës dhe asetet tjera publike, të cilat duhet t'i kthehen Autoritetit Kontraktues pas skadimit ose ndërprerjes së Marrëveshjes.

Proceset për futjen e kapitalit privat në ekonomi do të udhëhiqen nga një Komision Drejtues

që do të përdoret me qëllim të kompensimit të pjesshëm, ose të plotë, të shpenzimeve që ndërlidhen me transaksionin në fjalë, si dhe tarifën e mbikëqyrjes, që do të paguhet me qëllim të kompensimit të pjesshëm, ose të plotë, të shpenzimeve që ndërlidhen me monitorimin e përputhshmërisë së të gjitha palëve me Marrëveshjen PPP.

Po ashtu, Ligji lejon edhe mundësinë që një marrëveshje të lidhet pa procedura konkurruese nëse ekziston nevoja urgjente për sigurim të vazhdimësisë në ofrimin e shërbimit, ose kur projekti përfshin çështje që kanë të bëjnë me sigurinë publike.

Në anën tjetër, nuk jepet ndonjë specifikë çfarë do të bëhet me punëtorët e ndërmarrjeve publike dhe nëse ata do të gëzojnë ndonjë benefit, ose nëse këto ndërmarrje jepen me koncesion apo me qira.

Sipas Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, Ligji mbi PPP-të është tërësisht në pajtim me dispozitat legjislative model të UNCITRAL-it dhe EBRD-së, dhe me direktivat e BE-së lidhur me PPP-të dhe koncesionet.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, plani i investimeve paralogarit të jetë 85.1 milionë euro, ndërkaq benefiti i shtetit të Kosovës 400.1 milionë euro.

ndërtesat qeveritare dhe publike, punët komunale, shërbimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës bazë të TI dhe të dhënave; naftësullësit, gazsullësit, rafinerimi dhe distribuimi.

Kohëzgjatja e një Koncesioni, ose Partneriteti Publik-Privat, do të përcaktohet në marrëveshjen

Ndërministror i Partneriteteve Publiko-Private, i cili në të njëjtën kohë do t'i menaxhojë politikën e zhvillimit të partneriteteve publiko-privatë, e në të njëjtën kohë do ta bëjë edhe shqyrtimin, miratimin ose refuzimin e Propozim-Projekteve. Partnerët privatë do t'i paguajnë disa tarifa – tarifën e transaksionit,

## Qeveria i bie pishman – lejon ndërtimin e “Spitalit të Dalladakut”

Dy vjet më parë, më 3 tetor 2007, Komuna e Prishtinës i kishte dhënë leje Fatmir Dalladakut që, në kuadër të hapësirës së Qendrës Klinike dhe Universitare të Kosovës (QKUK), ta ndërtojë objektin për Qendrën Kardiologjike të Kosovës, ose, siç nisi të njihej - “Spitali i Dalladakut”.

Pas fillimit të punimeve, menaxhmenti i QKUK-së protestoi për këtë vendim të Komunës së Prishtinës (vendimi i Departamentit për Ndërtim 05, nr. 351 – 19192).

Një muaj pas marrjes së vendimit nga Komuna e Prishtinës, Qeveria e Kosovës, nën drejtimin e Agim Çekut, më 3 tetor 2007 mori

vendimin 07/274 për pezullimin e aktvendimit të KK të Prishtinës. Vendimi i Qeverisë Çeku u përkrah edhe nga Qeveria Thaçi, pasi më 12 qershor 2008, me vendimin 15/24, Qeveria e Kosovës edhe një herë i dha mbështetje vendimit 07/274 për ndërprerjen e punimeve

Prishtinës ka pasur të drejtë kur i ka lejuar Fatmir Dalladakut të ndërtojë objekt privat në kuadër të hapësirës publike të QKUK-së. Në pikën 2 të këtij vendimi, Qeveria e Kosovës deklaroi se e respekton partneritetin publiko-privat edhe në shëndetësi.

Me vendimin 08/70, Qeveria i hap rrugë partneritetit publiko-privat edhe në shëndetësi

në “Spitalin e Dalladakut”.

Tash, më shumë se një vit e gjysmë nga koha e ndërprerjes së punimeve, Qeveria e Kosovës i ka rënë pishman dhe ka vendosur që, megjithatë, Komuna e

Pas këtij vendimi, mund të pritët që edhe nisma tjera private të kërkojnë leje për ndërtim në kuadër të QKUK-së, ose hapësirave të tjera publike spitalore.

## Sa banorë i ka Kosova?– Përgjigjja është dy vjet larg

Edhe dy vjet nuk do të ketë regjistrim të përgjithshëm të popullsisë dhe ekonomive familjare në Kosovë. Kjo është bërë e qartë nga vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i datës 25 qershor 2009.

Ende pa filluar zbatimin e Ligjit për Duhanin, kërkohet ndryshimi dhe plotësimi i tij. Ndryshimet që parashihen të bëhen nuk kanë të bëjnë me përmirësimin e dispozitave të pazbatueshme, ngase ligji ende nuk ka filluar të zbatohet si pasojë e mosgatishmërisë së institucioneve. Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Duhanin nuk e ndryshon aspak përmbajtjen kryesore të ligjit në fuqi

Sipas Pakos së Ahtisaarit, e cila është pranuar nga Qeveria e Kosovës, regjistrimi i popullsisë do të duhej të bëhej një vit pas hyrjes në fuqi të kësaj Pakoje. Pako e Ahtisaarit konsiderohet se ka hyrë në fuqi më 17 shkurt 2008 dhe, sipas saj, regjistrimi i popullsisë do të duhej të ndodhte në mars të vitit 2009. Ky afat është shtyrë edhe për dy vjet.

Sipas vendimit të Qeverisë nr. 03/70, i propozohet Kuvendit të Kosovës që regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave të bëhet nga data 30 mars deri më 11 prill 2011. Ky vendim duhet të miratohet edhe nga Kuvendi i Kosovës.

Në mars të vitit 2011, kur do të realizohet regjistrimi i ardhshëm i popullsisë, do të bëhen 30 vjet që Kosova nuk ka pasur regjistrim të popullsisë. Regjistrimi i fundit është bërë më 1981. Mosekzistimi i statistikave të sakta të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, është problem që potencohet në çdo raport vlerësues të organizatave

ndërkombëtare, si FMN dhe Raporti i Progresit të Komisionit Evropian. Mungesa e këtyre statistikave fundamentale pamundëson edhe nxjerrjen e statistikave tjera që kanë të bëjnë me GDP-në, rritjen ekonomike, etj. Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën i vitit 2008, thotë: “Shpallja e parakohshme e regjistrimit të popullatës dhe dorëzimi pas afatit të rishikimit gjysmëvjeçar të Buxhetit janë bërë në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës”.

Sipas një publikimi të Entit të Statistikave të Kosovës (ESK), me titull: “Ndryshimet demografike të popullsisë së Kosovës në periudhën 1948-2006”, ceketse regjistrimi i parë në Kosovë është bërë në vitin e largët 1921 dhe deri tek regjistrimi i fundit zyrtar në Kosovë më 1981, rritja e popullsisë në Kosovë ka shkuar në këtë mënyrë:

Popullsia e Kosovës sipas përbërjes etnike 1921-2006

Vitet e Regjistrimit	Gjithsej	Shqiptarë	Serbë	Turq	Romë	Të tjerë
1921	439.010	-	-	-	-	-
1931	552.064	-	-	-	-	-
1948	733.034	498.244 (68%)	176.718 (24.1%)	1.320 (0,2%)	11.230 (1,5%)	45.522 (6,2%)
1953	815.908	524.562 (64,3%)	189.869 (23,3%)	34.590 (4,2%)	11.904 (1,5%)	54.983 (6,7%)
1961	963.988	646.605 (67,1%)	227.016 (23,5%)	25.764 (2,7%)	3.202 (0,3%)	61.401 (6,4%)
1971	1.243.693	916.168 (73,7%)	228.264 (18,4%)	12.244 (1%)	14.593 (1,2%)	72.424 (5,8%)
1981	1.584.440	1.226.736 (77,4%)	209.798 (13,2%)	12.513 (0,8%)	34.126 (2,2%)	101.267 (6,4%)
1991	1.956.196	1.596.072 (81,6%)	194.190 (9,9%)	10.445 (0,5%)	45.745 (2,3%)	109.744 (5,6%)
2006	2.100.000	1.932.000 (92%)	111.300 (5,3%)	8.400 (0,4%)	23.512 (1,1%)	24.788 (1,2%)

Për vitet 1948, 1953, 1961, 1971 dhe 1981, të dhënat janë nxjerrë nga publikimet e regjistrimeve.

Për vitin 1991, të dhënat janë vlerësim i EFS.

Për vitin 2006, të dhënat janë vlerësim i ESK.

Burimi: ESK

Regjistrimi i Popullsisë së Kosovës do të jetë kompetencë e Entit të Statistikave të Kosovës.

Në vitin 2005, ESK-ja ka themeluar Zyrën për Regjistrimin e Popullsisë. Që nga themelimi i kësaj zyre deri

më tash janë bërë tri regjistrime testuese të popullsisë (2005, 2006 dhe 2008).

## Ndahen mjetet për pagesën fillestare të anëtarësisë në Bankën Botërore

Anëtarësimi i Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe në Bankën Botërore (BB) është një sukses i madh për shtetin e ri të Kosovës.

Mirëpo, përveç përfitimeve politike dhe financiare që Kosova ka nga anëtarësimi në këto organizma ndërkombëtarë financiarë, anëtarësimi bart edhe obligime të ndryshme. Njëra ndër to është edhe pagesa e kuotës për anëtarësi. Sipas KASH 2010-12, anëtarësimi i Kosovës në këto dy organizma - buxhetit të vendit do t'i kushtojë rreth 150 milionë euro.

Këtë vit, Kosova ka ndarë 17 milionë euro për pagesën e

anëtarësisë në FMN dhe BB, kurse në vitet në vazhdim do të paguajë nga 700.000 euro në vit.

Nga kjo shumë, prej 17 milionë euro, Qeveria e Kosovës ka ndarë këstin e parë prej 1.674.638 euro. Kjo

Entitetet e Bankës Botërore, në të cilat do të anëtarësohet dhe nga të cilat do të përfitojë Kosova, janë pesë: Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), Asociacioni për Zhvillim Ndërkombëtar (IDA),

Sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2010-12, anëtarësimi në këto dy organizma do t'i kushtojë Kosovës rreth 150 milionë Euro.

shumë ndahet nga kodi - "Rezerva për implementimin e statusit".

Shuma tjetër e mjeteve parashihet të ndahet pas rishikimit buxhetor, në muajin e ardhshëm.

Kosovakanëshkruaranëtarësinë në këto dy organizma, më 29 qershor 2009.

Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), Agjencia për Garantimin e Investimeve Multilaterale (MIGA), Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Konfliktëve në Investime (ICSID).



## Bëhet hapi i parë në vënien e bazës ligjore për luftimin e krimit kibernetik

**P**ërderisa zhvillimi teknologjik dhe përdorimi gjithnjë e më i gjerë i internetit dhe transaksioneve të ndryshme të cilat bëhen përmes internetit ka bërë që të rriten edhe keqpërdorimet dhe krimet e natyrave të reja, në shumë vende të botës është parë nevoja që të nxirren norma të reja ligjore që synojnë vënien e kontrollit ligjor

Parandalimi dhe sanksionimi i krimeve kibernetike është bërë objekt trajtimi edhe i legjislacionit ndërkombëtar. Këshilli i Evropës, krahas imponimit të ratifikimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si aktin më të famshëm ligjor të kësaj organizate, tash me këmbëngulje kërkon nga shtetet e saja anëtare dhe joanëtare që të ratifikohet edhe Konventën

nga kjo fushë më shumë është nevojë e plotësimit të legjislacionit për t'i përmbushur obligimet që dalin si kërkesë e organizatave ndërkombëtare, siç janë Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian, sesa që është nevojë dhe kërkesë e brendshme urgjente për të pasur një Ligj të tillë. Legjislacioni nga kjo fushë është një nga legjislacionet më të vështira për t'u zbatuar edhe në vendet me sistem më të zhvilluar të sigurisë dhe ky Ligj vështirë se do të mund të gjejë zbatim të shpejtë në praktikë, si pasojë e mungesës së trupave të specializuara për luftimin e kësaj dukurie.

Edhe pse është një Ligj i ri dhe i vetmi i kësaj fushe në Kosovë, MEF-i nuk ka paraparë shpenzime shtesë të buxhetit për këtë Projektligj. Hyrja në fuqi e këtij Ligji është e pamundur të mos ketë efekte buxhetore shtesë, ngase kërkohet krijimi i strukturave të veçanta që e luftojnë këtë dukuri dhe kjo nuk mund të bëhet vetëm me kapacitetet aktuale të Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit.

Çështjet e krimit kibernetik janë çështje globale, andaj kërkohet edhe bashkëpunimi ndërkombëtar në këtë fushë. Bashkëpunimin ndërkombëtar e trajton edhe Projektligji për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit në Kibernetikë. Për këtë qëllim parashihet krijimi i një pike të përhershme kontakti për mbajtjen e kontakteve me jashtë, e cila nuk dihet se si do të emërtohet.

në këtë fushë.

Shkeljet në këtë fushë njihen si "krime kibernetike".

Krimi kibernetik nënkupton një aktivitet kriminal të zhvilluar në rrjet që ka si objekt, ose si mënyrë të kryerjes së krimit, keqpërdorimin e sistemeve kompjuterike dhe të dhënave kompjuterike.

mbi Krimin Kibernetik. Edhe legjislacioni i përbashkët i BE-së e trajton këtë fushë me direktivat e saj.

Radhës së shteteve të cilat i kanë miratuar ligjet kundër krimeve kibernetike, së shpejti do t'i bashkohet edhe Kosova. Mirëpo, miratimi i legjislacionit

Projektligji parasheh dënime të

ashpra në të holla dhe me burgim për të gjitha ata që i shkelin dispozitat e këtij Ligji. Dënimet me të holla sillen nga 500 euro deri 5000 euro, ndërsa dënimet me burgim sillen nga 6 muaj deri në 10 vjet. Me të holla dhe me burg dënohen të gjithë ata që përmes përdorimit të sistemeve kompjuterike cenojnë privatësinë, bëjnë thyerje të paligjshme të sistemeve kompjuterike, tjetërsim ose shlyerje të të dhënave, thyerje të sistemeve të sigurisë, etj.

Krimi më i dënueshëm, sipas këtij Ligji, do të jetë shpërndarja e pornografisë së fëmijëve në internet. Ky krim dënohet deri me 10 vjet burgim.

Sipas dispozitave përfundimtare të paraqitura në këtë Projektligj, në çdo kolizion potencial në mes të këtij Ligji dhe Kodit Penal të Kosovës, epërsi kanë dispozitat e këtij të fundit.

Ndonëse është Ligj i ri dhe unikal në këtë fushë për Kosovën, MEF-i nuk ka paraparë shpenzime shtesë buxhetore për këtë Projektligj. Është e pamundur që hyrja në fuqi e këtij Ligji të mos ketë efekte shtesë buxhetore, ngase kërkohet krijimi i strukturave të veçanta që e luftojnë këtë dukuri dhe kjo nuk mund të bëhet vetëm me kapacitetet aktuale të Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit. Për këtë duhet blerë teknologjia e nevojshme për monitorimin dhe zbatimin e Ligjit.

Gjithashtu, Projektligji nuk e bën të qartë se cili organ është përgjegjës për zbatimin e këtij Ligji.

Konstatimi i MEF-it se strukturat aktuale administrative që gjenden në kuadër të MTPT-së janë të mjaftueshme për zbatimin e Ligjit është i paqëndrueshëm,

ngase zbatimi i tij nuk mund të jetë kompetencë e vetëm një Ministrie, por është çështje që kërkon përfshirje multidisiplinare.

Në SHBA, kjo dukuri luftohet nga Qendra për Ankesat e Krimin anë Internet (Internet Crime Complaint Centre - IC3), e cila vepron ngushtë me Departamentin e Drejtësisë, CIA dhe FBI. Në Britani të Madhe, kjo çështje luftohet nga Njësia Qendrore Policore Kundër Krimin Elektronik, e cila më tutje është e ndarë në pesë nën-njësi: Ekipi i Krimeve Elektronike, Ekipi i Inteligjencës, Stafi i Komunikimeve, Ekipi i Zhvillimit të Partneriteteve dhe Ekipi i Parandalimit. Pothuajse të gjitha vendet e Evropës Perëndimore e kanë një njësi të veçantë të centralizuar që merret kryesisht me krimet kibernetike.

## Themelohet Zyra për Çështjen e Trashëgimisë së TMK-së

Qeveria e Kosovës, me vendimin 04/59, themeloi Zyrën për Çështjen e Trashëgimisë së TMK-së.

Ashtu siç parashihet edhe me Pakon e Ahtisaarit, TMK duhet të shpërbëhet brenda një viti, ngadita e hyrjes në fuqi të Pakos.

Ky proces përfundoi më 15 qershor 2009, kur Zyra e Koordinatorit të TMK-së u shua dhe filloi puna rreth themelimit të Zyrës për Çështjen e Trashëgimisë së TMK-së.

Vendimi për themelimin e kësaj Zyre bazohet në Ligjin

për Shpërbërjen e TMK-së.

Sipas Nenit 12.1 të këtij Ligji, Qeveria e Kosovës themelon një organ ndër-qeveritar për të koordinuar çështjet e

trashëgimisë së TMK-së. Mirëpo, vendimi i Qeverisë devijon nga ajo që parashihet me Nenin 12.1 të Ligjit për Shpërbërjen e TMK-së. Në Ligj thuhet se kjo Zyrë do të jetë ndër-qeveritare, kurse vendimi i Qeverisë këtë Zyrë e

Vendimi i Qeverisë devijon nga ajo që parashihet me Nenin 12.1 të Ligjit për Shpërbërjen e TMK-së. Në Ligj thuhet se kjo Zyrë do të jetë ndër-qeveritare, kurse vendimi i Qeverisë e vendos atë në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

vendos në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Ky fakt ka irrituar drejtuesit e kësaj Zyre. Përshtypja e tyre është se Qeveria s'ka interesim që t'ia

plotësojë kushtet e nevojshme kësaj Zyre - për të funksionuar normalisht.

Zyra për Çështjen e Trashëgimisë së TMK-së është e vendosur në kuadër të MPMS-së, e cila është obliguar që t'ia krijojë të gjitha hapësirat dhe kushtet për punë. Kjo Zyra parashihet të ketë gjithsej nëntë punëtorë. Një numër prej tre vetash tashmë janë duke punuar në këtë Zyrë, të gjithë nga strukturat e ish-TMK-së.

Po me këtë vendim, Qeveria e Kosovës obligon MPMS-në që të hartojë një rregullore të punës për këtë Zyrë. Sipas zyrtarëve të Zyrës për Çështjen e Trashëgimisë së TMK-së, drafti i rregullores është finalizuar dhe në shtator pritet të miratohet në Qeveri.

## Miratohen edhe katër strategji

Në numrin e kaluar të GAP Monitor, kemi trajtuar çështjen e strategjive të iniciuara nga ana e Qeverisë së Kosovës që nga janari i vitit 2008. Gjithashtu, në numrin e kaluar potencuam se që nga fillimi i punës së Qeverisë Thaçi janë iniciuar 20 strategji të ndryshme, numri më i madh i të cilave është në kompetencë të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Këtë muaj,

procedurë të hartimit.

Strategjitë e miratuara gjatë muajit qershor janë: 1. Strategjia Shtetërore Kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit; 2. Strategjia Shtetërore Kundër Drogave dhe Plani i Veprimit; 3. Strategjia dhe Plani Nacional i Veprimet për të Drejtat e Fëmijëve në Republikën e Kosovës 2009 – 2013; dhe 4. Strategjia Zhvillimore e Agjencisë

Me rastin e miratimit të strategjive, MEF-i nuk bën një vlerësim të ndikimit buxhetor, ashtu siç e bën për Projektligjet që i dërgohen Kuvendit. Zakonisht, strategjitë janë më të kushtueshme sesa shumë ligje që merren së bashku. Hyrja në fuqi e këtyre strategjive do t'i kushtojë buxhetit të Kosovës për periudhën 2009-2014 rreth 32 milionë euro, pa llogaritur ndikimin buxhetor të Planit të Veprimit Kundër Terrorizmit, i cili nuk është bërë i ditur për publikun, për shkak të fushës së ndjeshme që trajton.

Qeveria e Kosovës i ka miratuar edhe katër strategji të reja. Kjo bën që numri i strategjive të miratuara deri më tash gjatë kësaj qeverisjeje të jetë 18, kurse katër strategji të iniciuara ende mbeten në

Kadastrale të Kosovës 2009 – 2011 dhe Plani i Biznesit për Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe Sektorin Kadastral në Kosovë 2009 – 2014.

### Strategjia Shtetërore Kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit

është iniciuar me vendimin e Qeverisë nr. 09/44, të 6 nëntorit 2008. Hartimi i kësaj strategjie dhe i Planit të Veprimit ka qenë detyrë e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Shtatë muaj pas inicimit të procedurës, Qeveria e Kosovës, me vendimin 08/69, e ka miratuar këtë strategji. Sipas zyrtarëve të MPB-së, Plani i Veprimit Kundër Terrorizmit nuk do të bëhet i ditur për publikun, pasi që natyra e kësaj fushe e kërkon që ky plan të mbahet sekret, kurse strategjia është e hapur për publikun, edhe pse ende nuk është publikuar askund në ndonjë web-faqe zyrtare të Qeverisë së Kosovës. Kjo strategji planifikohet të zgjasë/implementohet në periudhën kohore 2009-2012. Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse kryesore për realizimin e objektivave të Strategjisë kundër Terrorizmit, dhe, respektivisht, planifikohet që ajo ta krijojë Njësinë e Monitorimit dhe Vlerësimit të Strategjisë në varësi

të Koordinatorit Nacional Kundër Terrorizimit.

Strategjia Kundër Terrorizmit është paraqitur si domosdoshmëri kundër kërcënimeve serioze ndaj të gjitha shteteve demokratike në botë, veçanërisht pas 11 shtatorit 2001.

Pa marrë parasysh që Kosova është shtet sekular dhe mjaft tolerant në aspektin e lirive fetare, theks i veçantë i vihet faktit se në Kosovë besimi dominues fetar është islami (rreth 90 për qind e popullsisë), kurse pjesa tjetër e popullsisë i takon besimit të krishterë.

Strategjia Shtetërore Kundër Terrorizmit ka për qëllim implementimin e një politike efektive kundër terrorizmit, strategji kjo që mbështetet në katër shtylla kryesore: parandalimi, ndjekja, mbrojtja dhe përgatitja, dhe reagimi. Qëllimi kryesor i këtyre masave është fillimisht, identifikimi me kohë i simptomave dhe i faktorëve të ndryshëm që mund të ndikojnë në aktet terroriste, mandej eventualisht parandalimi, ndjekja dhe hetimi i terroristëve brenda Republikës së Kosovës, duke i penguar aktet planifikuese terroriste, siç janë: qarkullimi i lirë, financimi, rekrutimi, etj. Qëllimet tjera të kësaj strategjie janë mbrojtja e cenusshmërisë së interesave të brendshme dhe të jashtme të Kosovës, si dhe përgatitja dhe reagimi me kohë ndaj ndonjë akti potencial terrorist. Paralelisht me qëllimet e masave të paraqitura, në këtë strategji parashihen edhe objektivat strategjike/planet dhe mekanizmat e veprimit.

Me këtë strategji synohet parandalimi dhe luftimi i terrorizmit përmes agjensioneve dhe institucioneve vendore dhe atyre ndërkombëtare, duke i shfrytëzuar mekanizmat koordinues, monitorues, implementues, ligjorë, operativë dhe konventat ndërkombëtare të cilat janë të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

Hierarkia ose struktura

organizative përmes së cilës zbatohet strategjia kundër terrorizmit, përfshin Mekanizmin Koordinues, Monitorues dhe Implementues. Në këtë kuptim, autoritetet kryesore për zbatimin e strategjisë kundër terrorizmit janë: Koordinatorit Nacional Kundër Terrorizmit, Këshilli i Sigurisë së Kosovës, Agjencia Kosovare për Inteligjencë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si dhe Prokuroria dhe Gjykata, respektivisht sipas nivelit të autoritetit, ose rëndësisë strategjike. Më tej, në Strategjinë Shtetërore Kundër Terrorizmit parashihet gjithashtu edhe niveli operativ, i cili është i klasifikuar në katër shtyllat kryesore të lartpërmendura (Parandalimi, Mbrojtja, Ndjekja dhe Reagimi). Për secilën nga këto masa strategjike janë të definuara autoritetet që do të merreshin me to. Për masën e Parandalimit në planin operativ parashihet të merret AKI, MPB, MASHT, MKRS dhe MEF, respektivisht sipas hierarkisë; për masën e Mbrojtjes është përgjegjëse MPB, MFSK dhe MEF; për masën e Ndjekjes është përgjegjëse MPB, Prokuroria dhe Gjykata, dhe MEF; ndërsa Strategjia kundër Terrorizmit parasheh që për masën e reagimit duhet të kujdeset MPB, MFSK dhe MAPL.

Strategjia kundër Terrorizmit i merr parasysh edhe mekanizmat legalë (bazën e legjislacionit të vendit), projektligjet që janë në procedurë të aprovimit dhe që ndërlidhen me terrorizmin në një mënyrë apo tjetër, si dhe deklaratat, konventat dhe aktet ndërkombëtare që janë të zbatueshme edhe në Republikën e Kosovës.

Strategjia Kundër Terrorizmit e Republikës së Kosovës nuk jep asnjë informacion rreth shpenzimeve që do të jenë barrë e Buxhetit të Kosovës për periudhën 2009-2012.

## Strategjia Shtetërore Kundër Drogave dhe Plani i Veprimit

po ashtu është iniciuar më 6 nëntor 2009. Edhe kjo strategji është hartuar dhe do të zbatohet nga Ministria e Punëve të Brendshme. Nga shumë kritikë të pavarësisë së Kosovës dhe në raporte të ndryshme ndërkombëtare, Kosova, ndër të tjera, është cilësuar edhe një vend ideal për trafikantët e drogave. Strategjia Kundër Drogave pritet që t'i ashpërsojë masat e organeve të rendit kundër kësaj dukurie dhe t'i eliminojë edhe ato arsye të pakta që shfrytëzohen në cilësimin e Kosovës si vend ideal për lulëzimin e trafikut të drogës.

Kjo strategji i përcakton objektivat e përgjithshme, objektivat specifike dhe aktivitetet me qëllim që t'i parandalojë, luftojë dhe t'i harmonizojë veprimet ndërinstytucionale vendore dhe ndërkombëtare, duke synuar kështu ndërtimin e një shoqërie të shëndetshme në Kosovë, pa kërcënime nga keqpërdorimi i drogave. Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit Kundër Drogave janë hartuar për afatin kohor 2009-2012. Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës Kundër Drogave ka si objektiva të përgjithshme reduktimin e kërkesës, reduktimin e ofertës dhe furnizimin, si dhe bashkëpunimin dhe koordinimin.

Në këtë strategji parashihet posti i Koordinatorit Nacional, i cili do të jetë personi përgjegjës, i mandatuar që të koordinojë, monitorojë dhe të raportojë për implementimin e politikave, aktiviteteve dhe veprimeve lidhur me drogat në Kosovë. Përmes kësaj strategjie gjithashtu parashihet edhe themelimi i Sekretariatit – një organ i ri, roli i të cilit do të jetë mbledhja e informacioneve dhe të dhënave

nga institucionet tjera me qëllim të analizimit dhe vlerësimit të tyre, si dhe përgatitja e raporteve analitike për Koordinatorin Nacional.

Plani i Veprimit kundër drogave parashtron metodat dhe aktivitetet specifike për secilën nga tri objektivat e përgjithshme, duke i precizuar institucionet përgjegjëse, afatet kohore, koston dhe treguesit përfundimtarë.

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit do të shtrihet në të gjitha institucionet bartëse dhe përgjegjëse për realizimin e objektivave të përcaktuara në Strategji dhe Plan të Veprimit.

Ministria e Punëve të Brendshme, si bartëse dhe përgjegjëse kryesore për realizimin e objektivave, do ta krijojë njësinë e monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë në vartësi të Koordinatorit Nacional kundër drogave. Kjo njësi do t'i monitorojë treguesit më të rëndësishëm që kanë të bëjnë me luftën kundër trafikimit me droga. Në fund të çdo viti, ajo duhet ta përgatisë një raport progresi për shkallën e realizimit të objektivave.

Ministritë e linjës (MD, MASHT, MEF, MSH, MPMS, MTI, MPB, MMPH, MKRS, MBZHR) do të përgjigjen për monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve që i kanë si bartës këto Ministri ose institucionet në vartësi të tyre, duke i përfshirë edhe prokuroritë dhe gjykatat. Këto institucione do t'i raportojnë periodikisht Koordinatorit Nacional në mënyrë që raportet të jenë të unifikuara.

Përveç shpenzimeve të cilat janë paraparë në buxhetin e Kosovës, kostoja shtesë për implementim e Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër drogave pritet të jetë rreth 5.471.400 euro. Këto mjete do të sigurohen nga Buxheti i Kosovës, kurse për disa aktivitete të caktuara edhe nga donatorët. Kjo kosto financiare është tepër e lartë për mundësitë buxhetore që ka Kosova dhe për shkak të saj vështirë se do të mund të realizohen të gjitha objektivat e parapara me strategji.

## Strategjia dhe Plani Nacional i Veprimet për të Drejtat e Fëmijëve në Republikën e Kosovës 2009 – 2013

nuk është iniciuar me ndonjë vendim të Qeverisë aktuale. Kjo strategji është hartuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë, që funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Dokumenti strategjik për fëmijët përbëhet nga dy pjesë: Strategjia dhe Plani i Veprimit. Në kuadër të këtyre dokumenteve janë të përfshira Vizioni dhe Misioni, Qëllimet, kurse është ofruar një analizë e situatës së të drejtave të fëmijëve në fushat prioritare si: Qeverisja, Buxheti, Arsimi, Shëndetësia, Mirëqenia Sociale, Drejtësia për të mitur, dhe çështje të tjera të rëndësishme ndër-sektoriale.

Plani i Veprimit përmban objektivat kryesore që synohen, aktivitetet e përcaktuara, institucionet përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve, planin kohor dhe linjën buxhetore. Për secilin objektiv janë përcaktuar indikatorët që do të shërbejnë si matës të progresit të zbatimit të masave të strategjisë në të ardhmen.

Sa i përket qeverisjes, objektivat strategjike që parashihen të zbatohen janë: zbatimi dhe rishikimi i legjisllacionit ekzistues dhe nxjerrja e legjisllacionit të ri për të drejtat e fëmijëve; funksionalizimi i Komitetit Ndërmintor për të drejtat e fëmijëve; institucionalizimi i plotë i pozitave të zyrtarëve për të drejtat e fëmijëve në nivelin qendror dhe atë komunal; krijimi i parakushteve të nevojshme për raportim për Konventën për të Drejtat e Fëmijës; forcimi i bashkëpunimit me institucionin e O m b u d s p e r s o n i t ; monitorimi i zbatimit të dispozitave të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

Për t'i adresuar çështjet më të rëndësishme në kuadër të fushës prioritare të arsimit janë përcaktuar këto objektiva: Gjithëpërfshirja e fëmijëve në arsim

cilësor; Sigurimi i gjithëpërfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim; Parandalimi dhe luftimi i dhunës në shkollë; Integrimi i fëmijëve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në arsim; Parandalimi dhe reagimi ndaj braktisjes së shkollës; Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucionet parashkollore; si dhe Krijimi i mekanizmave për përkrahje të fëmijëve të talentuar.

Me qëllim të adresimit të çështjeve më të rëndësishme në kuadër të fushës prioritare të shëndetësisë janë përcaktuar këto objektiva: Ruajtja dhe përparimi i gjendjes shëndetësore të shtatzënës, të porsalindurit dhe të fëmijës së vogël; Ulja e vdekshmërisë së të porsalindurve, fëmijëve dhe fëmijëve deri në moshën 5 vjeçare; Ulja e vdekshmërisë dhe e pasojave nga lëndimet të fëmijët; Përmirësimi i qasjes në shërbimet shëndetësore dhe cilësisë së barabartë për të gjithë fëmijët; Nxitja dhe përkrahja e pjesëmarrjes aktive të fëmijëve dhe të rinjve në krijimin, zbatimin dhe përcjelljen e programeve dhe të masave preventive për shëndetin; Nxitja e formave bashkëkohore të humanizimit të spitaleve gjatë shërimit dhe trajtimit të fëmijëve; si dhe Ruajtja dhe përparimi i shëndetit të rinisë.

Kurse, për t'iu qasur çështjeve më të rëndësishme në kuadër të fushës prioritare të mirëqenies sociale, janë përcaktuar këto objektiva: Mbrojtja e fëmijëve nga punët e rënda dhe të rrezikshme; Ofrimi i shërbimeve për fëmijët pa përkujdesje prindërore; Integrimi, mbrojtja dhe ofrimi i shërbimeve adekuate për fëmijët me aftësi të kufizuara; Përmirësimi i jetës së fëmijëve që jetojnë në varfëri; Parandalimi i trafikimit dhe mbrojtja e fëmijëve të trafikuar; Mbrojtja e fëmijëve të keqtrajtuar brenda dhe jashtë familjes; si dhe Zbatimi dhe rishikimi i legjisllacionit që rregullon aspektet e mirëqenies sociale të fëmijës.

Në mënyrë që të zbatohen detyrat e përcaktuara dhe të raportohet e të monitorohet ky plan i veprimit, është e nevojshme që të funksionalizohet Komiteti Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijëve, i cili është caktuar që tani e tutje të ketë takim pune dy herë

në vit. Kryeministri i Republikës së Kosovës është kryesues i Komitetit.

Strategjia Zhvillimore e Agjencisë Kadastrale të Kosovës 2009 – 2011 dhe Plani i Biznesit për Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe Sektorin Kadastral në Kosovë 2009 – 2014. Kadastra është përballur me probleme të shumta që nga paslufta, si pasojë e marrjes së dokumentacionit kadastral nga ana e Serbisë.

Në Pakon e Ahtisaarit thuhet se me hyrjen në fuqi të Pakos, Serbia duhet t'ia kthejë Kosovës dokumentacionin kadastral. Një gjë e tillë ende nuk ka ndodhur.

Agjencia Kadastrale e Kosovës është themeluar në vitin 2000 dhe momentalisht funksionon në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Mirëpo, vendimin e Qeverisë nr. 04/63, ajo ka vendosur që Agjencioni Kadastral i Kosovës (AKK) të kalojë nën Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Mirëpo, strategjia dhe plani i biznesit në tërë dokumentin flasin për funksionimin e AKK-së në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike.

Strategjia dhe Plani i Biznesit janë dokumente voluminoze të cilat i shpjegojnë shumë qartë objektivat, aktivitetet dhe mjetet financiare që nevojiten për implementimin e aktiviteteve dhe periudhat kohore.

Me këtë strategji, AKK synon t'i arrijë katër objektiva gjithëpërfshirëse: 1. AKK të sigurojë administrim të kontrolluar të kualitetit të regjistrave dhe të ushtrijë kontroll duke u fokusuar në shërbime; 2. AKK të sigurojë shërbime të duhura dhe për pjesë të ndryshme t'i regjistrojë të dhënat e përshtatura sipas nevojës së përdoruesit; 3. AKK duhet ta thjeshtojë raportin e biznesit ndaj autoriteteve publike; 4. AKK duhet ta përfitojë një pjesë të realizimit të të hyrave nga shërbimet. Plani i Biznesit është i bazuar në strategji dhe paraqet në mënyrë më të detajuar hapat për përmbushjen e objektivave, si dhe koordinimin në mes AKK-së dhe Zyrave Lokale Kadastrale. Zbatimi i planit të biznesit për periudhën pesëvjeçare do t'i kushtojë Buxhetit të Kosovës mbi 20 milionë euro.

## Dërgohen në Kuvend emrat e kandidatëve për anëtarë të Bordit të ART-së

Në prag të pushimeve të Kuvendit, Qeveria ka dërguar emrat për Bordin më të përfolur në vend.

Qeveria e Kosovës, më 25 qershor, i ka propozuar Kuvendit të Kosovës pesë kandidatë për anëtarë të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit.

Bordi i vjetër i këtij Agjencioni ka vazhduar me lëshimin e licencave edhe në vitin 2009, edhe pse pa fuqi ligjore. Po ashtu, anëtarët e tij janë paguar nga Buxheti i Kosovës, edhe pas skadimit të mandatit të këtij Bordi.

Ekrem Hoxha është propozuar kryesues, ndërsa anëtarë janë propozuar: Lulëzim Kurtaj, Besnik Berisha, Naser Shala dhe Njazi Ademaj.

Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit është pa Bord që nga dhjetori i vitit 2008, kur anëtarëve të tij u ka skaduar

mandati. Megjithatë, Bordi i vjetër i këtij Agjencioni ka vazhduar me lëshimin e licencave edhe në vitin 2009, ndonëse pa fuqi ligjore. Po ashtu, anëtarët e tij janë paguar nga Buxheti i Kosovës, edhe pas skadimit të mandatit të këtij Bordi.

Instituti GAP ka siguruar CV-të e anëtarëve, të cilat i janë dërguar

Kuvendit të Kosovës për miratim.

Aty shihet se Ekrem Hoxha, i propozuar si Kryesues i Bordit, është jurist me profesion dhe mban titullin Bachelor. Ai ka punuar në organizata të ndryshme joqeveritare dhe në firma private, ndërsa një kohë ka qenë Drejtor në Agjencionin për Zhvillim të Ndërmarrjeve në

Kosovë. Besnik Berisha ka të kryer Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe ka punuar në ART si udhëheqës i sektorit të licencimit dhe përcaktimit frekuencor. Lulëzim Kurtaj ka të mbaruar Fakultetin e Elektroteknikës dhe ka qenë anëtar në Bordin e ART-së edhe mandatin e mëhershëm. Naser Shala është Profesor në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës, ndërkaq që përvojë pune ka edhe në firma private dhe në Qendrën Klinike Universitare të Prishtinës. Njazi Ademaj është ish deputet i LDK-së, ekonomist me profesion.

ART është institucioni më i kritikuar nga Kuvendi për mungesë kooperimi dhe transparence.

ART është institucioni i cili duhet të ndalojë punën e operatorëve ilegalë të telefonisë në vend dhe të përzgjedhë kompanitë e përgjegjshme për furnizim me licenca për tregun e telekomit.



## Qeveria subvencionon korrje-shirjet me 500 mijë euro

Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 qershor, ka miratuar kërkesën e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për subvencionimin me derivate të naftës për autokombajnata e angazhuara në fushatën e korrje-shirjeve për vitin 2009.

Mjetet në vlerë prej 500 mijë eurosh është vendosur të ndahen nga rezervat e paparashikuara të Qeverisë së Kosovës dhe i janë bartur Ministrisë së Bujqësisë.

Kjo ide është miratuar, edhe pse ka pasur kundërshtime nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Ahmet Shala, i cili i është kundërvënë Ministrit të Bujqësisë, Idriz Vehapi, që kishte bërë kërkesën për subvencionet.

Duke përkrahur politikat konservatore të rekomanduara nga FMN-ja për menaxhimin e buxhetit, ai ka tërhequr vërejtjen se kjo është formë artificiale e ndihmës

që nuk nxit zhvillim të mëtejshëm ekonomik. Shala ka kërkuar që ndihma për sektorin e bujqësisë të shtrohet në një platformë më afatgjate dhe të zgjidhet me mënyra

më 29 maj të vitit 2009, Qeveria e Kosovës ka vendosur të transferojë 372 mijë euro për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nga Programi i Departamentit

Ndarjen e këtyre mjeteve e ka kërkuar Ministri i Bujqësisë. Ministri i MEF-it, ndërkaq, ka kundërshtuar këtë mënyrë të subvencionimit ad-hoc të bujqësisë, me arsyetimin se një formë e tillë e shpenzimit të buxhetit - është në kundërshtim me rekomandimet e FMN-së dhe nuk i kontribuon zgjidhjes afatgjate të problemeve. Mirëpo, vërejtja e Ministrit të MEF-it nuk është marrë parasysh nga kabineti qeveritar

më efektive të ndihmës së bujqve. Vërejtja nuk është përfillur nga kabineti qeveritar dhe propozimi është votuar në mënyrë unanime.

Qeveria e Kosovës edhe më herët i është përgjigjur kërkesave të kësaj Ministrie për transfer të paplanifikuar të mjeteve.

Në mbledhjen e 66-të, të mbajtur

të Prodhimtarisë Blegtorale, në kategorinë për subvencione dhe transfere. Këto mjete janë transferuar për përkrahjen e fermerëve që mbajnë bagëti. Dhe, sipas Ministrisë së Bujqësisë, kjo formë e përkrahjes do të vazhdojë edhe në të ardhmen.



## Qeveria i kërkon Kuvendit që Zhuri të shpallet zonë me interes të veçantë ekonomik

Në mbledhjen e 69 të saj, të mbajtur më 19 qershor, Qeveria e Kosovës i ka propozuar Kuvendit të Kosovës që ta shpallë “zonë të interesit të veçantë ekonomik” hapësirën ku do të ndërtohet Hidrocentrali i Zhurit, për t’i nisur kështu aktivitetet që i paraprijnë ndërtimit të hidrocentralit 400 megavatesh.

Zona të cilën Qeveria ka kërkuar që të shpallet zonë e interesit të veçantë gjendet në një sipërfaqe prej 19.41 kilometrash katrorë, në jugperëndim të Prizrenit, shtrihet në 25 zona kadastrale dhe përfshin një numër njësisish gjeografike si: prurjet e rrjedhave nga vargmalet e Sharrit, akumulimin artificial të Plavës, akumulimin artificial të Breznes dhe objektin e Hidrocentralit të Zhurit.

Kohë më parë, Qeveria e Kosovës, me sugjerimin e Komitetit Drejtues të Projektit “Kosova e Re”, kishte marrë vendim që zonë me interes të veçantë ta shpallë edhe “Fushën e Mihjes së Re” - vendim ky që nuk ka kaluar nëpër Kuvend, pasi që Kuvendi, me propozimin e Qeverisë së Kosovës, i ka dhënë komitetit drejtues autoritetin për t’i marrë të gjitha vendimet në lidhje me projektin për ndërtimin e Termocentralit të Ri.

Para Qeverisë këtë kërkesë e ka prezantuar Ministria e Energjisë dhe Minierave, Justina Pula.

Në vendimin e Qeverisë thuhet se qëllimi i shpalljes së kësaj zone me interes të veçantë ekonomik është ndërtimi i hidrocentralit të ri, si dhe mbrojtja e zonës ujëmbledhëse dhe rrjedhjeve të lumenjve. Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor është obliguar që ta hartojë planin hapësinor për këtë zonë. Qeveria më herët kishte përgatitur dhe prezantuar studimin e fizibilitetit për ngritjen e këtij hidrocentrali.

“Shpallja e zonës me interes të veçantë ekonomik dhe hartimi i planit

hapësinor për këtë zonë bëhet me qëllim të identifikimit të ndryshimeve të strukturës hapësinore, shfrytëzimit të tokës dhe zhvendosjes së komunitetit në atë zonë, duke pasur parasysh investimet që do të bëhen në sektorin e energjisë.”, thuhet në dokumentin e përgatitur nga Qeveria e Kosovës.

Sipas kësaj të fundit, hartimi i planit hapësinor për zonën me interes të veçantë ekonomik bëhet duke u bazuar në Ligjin mbi Planifikimin Hapësinor dhe në përputhje me udhëzimin administrativ mbi “Elementet Themelore të Përbajtjes së Planeve Hapësinore për Zonat e Veçanta”.

Justina Pula, Ministria e Energjisë dhe Minierave, ka rikujtuar se Traktati i Athinës për Komunitetin

e Energjisë, nënshkruese e së cilës është edhe Kosova, fton për implementimin e politikave të BE-së për sektorin e energjisë, në të cilat kërkohet edhe prodhimi i një sasive të caktuar të rrymës nga burimet e ripërtërishme të energjisë.

“Politikat e BE-së parashohin që deri në vitin 2020 njëzet për qind e energjisë së përgjithshme të prodhohet nga këto burime. Kosova prodhon vetëm 3 për qind të energjisë nga uji”, ka thënë Pula, për të shtuar se MEM-i ka identifikuar disa projekte me të cilat mund të rritet pjesëmarrja e këtyre burimeve në prodhimin e rrymës.

Zhuri është vetëm njëri ndër projektet, ndërkohë që Qeveria ka identifikuar edhe 18 pika për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla. Ky hidrocentral paraqet më shumë se 50 për qind të tërë hidropotencialit për prodhimin e energjisë në vend.

Në dokumentin e Qeverisë thuhet se me ngritjen e këtij hidrocentrali do të mund të arrihen shumë përfitime: krijimi i kapaciteteve të konsiderueshme gjeneruese të energjisë së peakut, të cilat mungojnë në Kosovë, diversifikimi i kapaciteteve për prodhimin e energjisë, rritja e sigurisë së furnizimit me rrymë, si dhe përbushja e një pjese të konsiderueshme të obligimit që del prej politikave të BE-së për prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtërishme.

Plani Hapësinor i cili do të përgatitet në ditët në vijim, do t’i përshkruajë implikimet hapësinore të ndërtimit të Hidrocentralit të Zhurit. Planet tjera, hartimin e të cilave e ka kërkuar Qeveria, përfshijnë një vlerësim të aktiviteteve të planifikuara, ndikimin e tyre në mjedis dhe vlerësimin e hollësishëm të ndikimit ekonomik për ndërtimin e hidrocentralit në atë zonë.

Kuvendi ka miratuar kërkesën e Qeverisë për ta shpallur këtë hapësirë si zonë me interes të veçantë ekonomik për ndërtimin e Hidrocentralit “Zhur”, sipas Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës.

Kohë më parë, Qeveria e Kosovës, me sugjerimin e Komitetit Drejtues të Projektit “Kosova e Re”, kishte marrë vendim që zonë me interes të veçantë ta shpallë edhe “Fushën e Mihjes së Re” - vendim ky që nuk ka kaluar nëpër Kuvend, pasi që Kuvendi, me propozimin e Qeverisë së Kosovës, i ka dhënë komitetit drejtues autoritetin për t’i marrë të gjitha vendimet në lidhje me projektin për ndërtimin e Termocentralit të Ri.

## Formohet Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve të Shkaktuara nga Breshri në Gjilan

Në mbledhjen e saj të 67-të, më 5 qershor të vitit 2009, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që të formojë Komisionin Qeveritar për Vlerësimin e Dëmeve të Shkaktuara nga Breshëri, në Komunën e Gjilanit.

Komisioni do të kryesohet nga përfaqësuesi i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si dhe do të ketë një anëtar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, një nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, një nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe

një anëtar nga Kuvendi Komunal i Gjilanit.

Në bazë të vlerësimeve të këtij Komisioni, Qeveria do të ndihmojë në sanimin e dëmtimeve, sidomos të shtëpive të banimit në këtë rajon.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka bërë të ditur se ka formuar Komisionin ndërqeveritar, duke u bazuar në vendimin e lartcekur, me anëtarë nga MMPH, MBPZHR, MAPL, MEF dhe Komuna e Gjilanit.

Ky Komision, sipas MMPH-së, do të përgatisë raport të detajuar për

një kohë shumë të shkurtër.

Më herët, Kuvendi Komunal i Gjilanit i kishte dërguar një letër institucioneve të Kosovës, duke kërkuar ndihmë për të kompensuar dëmet e shkaktuara nga breshëri në këtë Komunë. Sipas tyre, breshëri që ka rënë në këtë regjion - ka shkaktuar dëme materiale në vlerë prej 3 milionë eurosh. Sipas të dhënave zyrtare, nga kjo Komunë, janë dëmtuar rreth 80 për qind të bujqësisë, ndërkaq 1/3 e familjeve kanë pësuar dëme në shtëpi dhe vetura, përderisa ka pasur edhe të lënduar.

## Zyra për Komunitete bëhet pjesë e programit të USAID për ndryshime pozitive

Zyra për Çështje të Komuniteteve, në Zyrën e Kryeministrit, ka nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Akademinë për Zhvillimin e Arsimit (AED), lidhur me programin për Nismën e Ndryshimeve Pozitive, financuar nga USAID.

Ky program, i lansuar që nga fillimi i këtij viti, mbështetet me 250 mijë euro nga USAID-i amerikan.

Në mbledhjen e mbajtur më 19 qershor të këtij viti, Qeveria e Kosovës i ka dhënë

mbështetje Zyrës për Çështje të Komuniteteve që ta nënshkruajë këtë memorandum - i cili Zyrën për Çështje të Komuniteteve e obligon që të ofrojë hapësirën, pajisjet dhe përkrahjen profesionale për këshilltarët e këtij programi.

Projektet për mbështetjen e ngritjes së kapaciteteve të komuniteteve pritet të zbatohen brenda një periudhe dyvjeçare.

Akademia për Zhvillimin e Arsimit do të ndihmojë Zyrën për Komunitete për të ngritur kapacitetet e saj, si dhe në trajnimin e zyrtarit për marrëdhënie me publikun dhe atij për koordinimin e ndihmës financiare - pozita këto që pritet të

plotësohen në të ardhmen.

Ndryshe, Qeveria e Kosovës më herët kishte ndarë 1 milion euro për Zyrën për Çështje të Komuniteteve, e cila është përgjegjëse për të zbatuar projektet që përkrahin një kthim të qëndrueshëm në Kosovë.

Projekti për Inicimin e Ndryshimeve Pozitive është projekt i USAID-it, i cili ka për qëllim të ndihmojë komunitetet minoritare për të përmirësuar kualitetin e tyre të jetës, për të krijuar mundësi më të shumta ekonomike, për të adresuar çështjet e sigurisë, si dhe për të krijuar marrëdhënie të qëndrueshme me institucionet vendase dhe ndërkombëtare.

## Miratohet Projektligji për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit

Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e saj të 67-të, ka miratuar Projektligjin për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit.

Qëllimi i këtij Projektligji është krijimi i kushteve për banim të qëndrueshëm për familjet ose individët të cilët nuk janë në gjendje ekonomike t'i përballojnë ofertat e tregut të lirë të banesave, si dhe caktimi i mënyrës së sigurimit dhe shfrytëzimit të mjeteve financiare për zhvillimin e programeve të veçanta të banimit.

Për shkak të të ardhurave të ulëta, shumë familje nuk kanë mundësi që të përballojnë pagesën e qirasë për banim, si pasojë e çmimeve të larta që i ofron tregu në Kosovë.

banesë ose shtëpi në pronësi individuale; kanë mbetur pa banesë-shtëpi si rezultat i dëmtimit të shtëpive gjatë luftës së fundit në Kosovë; si dhe familjet që posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e banimit.

Kriteret për përcaktimin e radhës së përparësisë për sigurimin e banimit janë: statusi i banimit, lartësia e të ardhurave, gjendja shëndetësore, invaliditeti dhe struktura e familjes.

Familjeve që u jepet e drejta të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit duhet që të ketë të ardhura të përmuajshme së paku prej 105 eurosh, si dhe të mos kenë të ardhura më shumë se 300 euro.

Shuma e ndarë e mjeteve për

Qiramarrësi, përveç qirasë, paguan edhe të gjitha shpenzimet tjera që lidhen me shfrytëzimin e zakonshëm të banesës.

Organet kompetente komunale, me vendim të Kuvendit Komunal, mund të lejojnë bonuse të banimit për shfrytëzimin e banesave me qira nga tregu, për familjet që plotësojnë kushtet në bazë të këtij Ligji.

Me Projektligj parashihet edhe themelimi i Këshillit Qendror për Banim. Këshilli Qendror për Banim është organ këshillëdhënës, në kuadër të MMPH, i cili zgjidhet me vendim të Qeverisë së Kosovës. KQB përbëhet prej pesë anëtarëve, të cilëve u takon kompensimi në formë të mëditjeve për çdo takim.

Ky Ligj do t'u ndihmonte shumë familjeve nëse do të mund të zbatohet në tërësi. Jo të gjitha familjet do të mund të përfitojnë nga dispozitat e këtij Ligji. Sipas vlerësimit të ndikimit buxhetor që ka bërë MEF për këtë Projektligj, hyrja në fuqi e këtij Ligji do të rëndoje shumë Buxhetin e Kosovës. MEF nuk ka mundur të përllogarisë me saktësi vlerën reale të Projektligjit, mirëpo, sipas disa përllogaritjeve të MEF-it, ky Ligj do të ketë një kosto buxhetore prej 2 milionë eurosh në vit, ku 1.5 milion euro nevojiten për ndërtimin e ndërtesave të banimit, kurse 0.5 milion euro për subvencionimin e qirasë. Kjo kosto përllogaritet që të jetë e njëjtë për dhjetë vjetët në vazhdim. Këto mjete shtesë buxhetore nuk janë paraparë as me Buxhetin e vitit 2009, por as me KASH 2010-12. Andaj, në mungesë të mjeteve, Kuvendet Komunale, në bazë të buxhetit të tyre, në fillim të çdo viti, do të përcaktojnë një numër të familjeve që do të mund të jetë përfituese nga këto programe, e që nuk do të jenë të gjitha familjet në nevojë.

### Projektligji i ri parasheh që Qeveria dhe komunat të subvencionojnë familjet të cilat financiarisht nuk mund të përballojnë ofertat e tregut të lirë të banesave

Sipas përmbajtjes së këtij Projektligji, për familjet të cilat nuk do të mund të përballojnë pagesën e banimit dhe qirasë - do të përkujdeset Komuna dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Sigurimi i banimit do të bëhet me programe të veçanta të financimit për banesa me qira, ku përfshihen: banesat e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe donatorët; banesat ekzistuese në pronësi të personave fizikë ose juridikë - të cilat mund të jepen me qira për familjet që posedojnë bonus të banimit; si dhe banesat tjera në pronësi të Komunës që mund të adaptohen për banim.

Kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet për banim - caktohen me vendim të Kuvendit Komunal përkatës dhe përfshijnë familjet që: nuk kanë

qira nuk duhet të kalojë 25% të të hyrave të përgjithshme të asaj familjeje. Sipas kësaj, nëse një familje ka të ardhura minimale prej 105 euro në muaj, ajo duhet të ndajë 26 euro në muaj për qira, kurse me 26 euro shtesë në muaj do të kontribuojë Kuvendi Komunal, duke bërë që shuma e përmuajshme për qira të jetë 52 euro në një banesë prej 45m<sup>2</sup>.

Për shfrytëzimin e banesave lidhet kontrata me shkrim për qira, ndërmjet autoriteteve komunale dhe familjes përfituese.

Kuvendi Komunal, për çdo vit, aprovon shumën e qirasë vjetore për banesat me qira.

Qiraja e grumbulluar nga banesat shfrytëzohet për mbulimin e kostos së administrimit, mirëmbajtjes, amortizimit, riparimet e rregullta dhe investuese të objektit të banimit.



## Formohet Bordi Këshillëdhënës për Promovimin e Investimeve

Në mbledhjen e 68-të të Qeverisë së Kosovës, të mbajtur më 12 qershor të vitit 2009, është marrë vendimi për formimin e Bordit Këshillëdhënës për Promovimin e Investimeve në Kosovë, i cili do ta këshillojë Agjencinë për Promovimin e Investimeve.

Ky Bord, i cili përbëhet nga Ministri i Tregtisë dhe Industrisë si kryesues, Ministri i Ekonomisë dhe Financave, përfaqësuesi i Odës Ekonomike të Kosovës, dhe nga dy përfaqësues nga investitorët privatë vendorë dhe nga Qeveria -- të cilët pritet të emërohen së shpejti -- nuk do të ketë ndonjë rol ekzekutiv dhe pritet të mblidhet deri dy herë në vit.

Bordi do të shqyrtoj punën e Agjencisë për Promovimin e investimeve, e cila vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë

dhe Industrisë, si dhe do të këshillojë këtë Agjencion.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka bërë të ditur se tash është në proces të hartimit të Strategjisë për Promovimin e Investimeve në Kosovë, e cila,

me iniciativën e vet, mund t'i ofrojë këshilla dhe rekomandime Agjencisë lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me të gjitha aktivitetet dhe funksionet e Agjencisë.

Drejtori i kësaj Agjencie, pasi

Ky Bord nuk do të ketë ndonjë rol ekzekutiv dhe pritet të mblidhet deri dy herë në vit

sipas Ministrit Lutfi Zharku, është duke u ndihmuar edhe nga Banka Botërore.

Bordi Këshillëdhënës për Promovimin e Investimeve në Kosovë është formuar në bazë të Ligjit për Investime, qëllimi i të cilit është nxitja dhe inkurajimi i investimeve të huaja në Kosovë.

Bordi Këshillëdhënës për Promovimin e Investimeve ("Bordi"), sipas këtij Ligji, do të themelohet si organ këshillëdhënës i Agjencisë. Ai, me kërkesën e Drejtorit ose

të shqyrtojë rekomandimet, mund t'i pranojë ose t'i refuzojë ato.

Anëtarët e Bordit, me këtë Ligj, nuk marrin kurrfarë kompensimi për ushtrimin e detyrës së tyre në Bord.

Ky Ligj, përpos Bordit Këshillëdhënës, parasheh edhe formimin e Këshillit të Investitorëve të Huaj, i cili duhet të emërohet nga Zyra e Kryeministrit, si organ i pavarur vullnetar këshillëdhënës i Zyrës së Kryeministrit -- që kryesohet nga Kryeministri.

## Qeveria përkrah një simpozium për ndriçimin e aktiviteteve të lëvizjes çlirimtare

Me rastin e 10 vjetorit të çlirimit të Kosovës, Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor, ka miratuar kërkesën e Institutit të Historisë për ndarjen e mjeteve në vlerë prej 13,691 euro - me qëllim të

pasqyimit të ngjarjeve historike të cilat kanë sjell çlirimin e vendit.

Ky simpozium, ku kanë marrë pjesë pjesëtarë të ish Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe historianë, ka qenë një ndër aktivitetet e vetme të

Ky simpozium, ku kanë marrë pjesë pjesëtarë të ish Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe historianë, ka qenë një ndër aktivitetet e vetme të organizuara nga Qeveria e Kosovës me rastin e dhjetëvjetorit të çlirimit.

organizimit të simpoziumit shkencor "Çlirimi i Kosovës".

Këto mjete janë ndarë nga fondi i shpenzimeve të paparashikuara të Qeverisë.

Simpoziumi është organizuar në të njëjtën datë, me qëllim të

organizuara nga Qeveria e Kosovës me rastin e dhjetëvjetorit të çlirimit.

Sipas Jusuf Bajraktarit, Drejtor i Institutit të Historisë së Kosovës, i cili ka organizuar këtë simpozium, promovimi i vlerave të UÇK-së është obligim i Qeverisë së Kosovës.

Në këtë simpozium, ndër të tjerë, kanë marrë pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit të Kosovës, Ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Islam Lauka, Komandanti i ish UÇK-së Agim Çeku, personalitetet e tjera që organizuan lëvizjen çlirimtare në vend, si dhe përfaqësues të institucioneve.

Ky simpozium, krahas historikut të lëvizjes çlirimtare, po ashtu, ka mbuluar edhe tema tjera të njëzetvjeçarit të fundit të historisë kosovare, duke filluar që nga marrja e autonomisë së Kosovës.

Me rastin e dhjetëvjetorit të çlirimit, Qeveria e Kosovës, gjithashtu, ka përkrahur organizimin e një festivali ndërkombëtar muzikor "Freedom Fest", që është mbajtur në Prishtinë, për të cilin Qeveria ka ndarë 40 mijë euro.

## Miratohet Projektligji për Mbrojtjen e Topografisë së Qarqeve të Integruara

Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin për Mbrojtjen e Topografisë së Qarqeve të Integruara.

Shumë nga lexuesit mund të pyesin, me të drejtë, se çfarë rregullon ky Ligj, në të ardhmen?

Projektligji rregullon çështje të pronësisë të prodhimeve industriale dhe ai mund të deshifrohet vetëm

pronësi të tij pranë Zyrës për Pronësi Industriale në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI).

Një topografi regjistrohet dhe mbrohet vetëm nëse ajo është origjinale. Një topografi konsiderohet origjinale nëse është rezultat i përpjekjeve intelektuale të vetë krijuesit dhe në momentin e krijimit nuk përbën rast të zakonshëm në

cenuar e drejta, bashkë me kompensimin e dëmit – mund të kërkojë edhe marrjen e masave të pengimit të cenimit të mëtutjeshëm të të drejtave.

Sipas memorandumit shpjegues që MTI i ka bashkangjitur këtij Projektligji, thuhet se ky Projektligj "duhet" të miratohet për shkak se kështu e kërkojnë direktivat.

Gjithashtu, ky Ligj është i nevojshëm që të miratohet nëse dëshirojmë që Zyra për Pronësi Industriale të jetë anëtare e organizatave botërore të pronësisë industriale, siç janë WIPO (World Intellectual Property Organisation) dhe EPO (European Patent Office).

Hyrja në fuqi e këtij Ligji nuk do të ketë ndonjë ndikim të madh buxhetor. Për implementimin e tij, do të punësohen edhe dy persona shtesë, ku rroga e tyre, së bashku me blerjen e kompjuterëve dhe inventarit përcjellës, për një vit, Buxhetit të Kosovës do t'i kushtojë 8.862 euro.

Miratimi i këtij Projektligji më shumë është nevojë për plotësimin e standardeve të jashtme, sesa që ekziston nevoja në realitet

nga profesionistët e kësaj fushe.

Sipas shpjegimeve në hyrje të Projektligjit, "Topografia e qarkut të integruar" nënkupton një vendosje tredimensionale e çfarëdoshme, e shprehurprejelementesh, kutëpaktën njëri është aktiv dhe ndërmjetësohet në qarqet e integruara, ose vendosje tredimensionale e përgatitur për prodhimin e një qarku të integruar.

Krijuesi i një topografie të qarkut të integruar mund ta regjistrojë atë në

industrinë e gjysmë-përçuesve.

Projektligji jep informata edhe për dokumentacionin e nevojshëm që duhet të dorëzohet me rastin e paraqitjes së kërkesës për mbrojtjen e topografisë. Të gjitha topografitë e mbrojtura, që janë regjistruar në kuadër të Zyrës për Pronësi Industriale, paraqiten në një regjistër zyrtar i cili është publik.

Bartësit të të drejtave të topografisë së mbrojtur, të cilit i është



## Emërohet Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike

Në mbledhjen e 68-të, mbajtur më 12 qershor të vitit 2009, Qeveria e Kosovës ka miratuar rekomandimet e Komisionit Përzgjedhës për Emërimin e Anëtarëve të Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike.

Ky Komision është formuar në bazë të Ligjit për Aviacionin Civil, dhe përbëhet prej tre anëtarëve:

Armend Verbovci - kryesues, inspektor i operimeve, Kreshnik Gashi - inspektor i inxhinierisë, dhe Arben Gashi - inspektor i incizuesit të fluturimeve.

Me Ligj, ky Komision është i pavarur nga Zyra e Aviacionit Civil, Ministria e Transportit, Ministria e Punëve dhe Brendshme dhe zyrtarët e tjerë politikë.

Ky Komision nënshtrohet auditimit sikurse të gjitha institucionet tjera

publike. Njëherësh, është përgjegjës për hetimin e aksidenteve dhe incidenteve ajrore brenda Kosovës, ose aksidentet dhe incidentet ku përfshihen avionët e regjistruar në Kosovë, pa marrë parasysh se në ç'vend ka ndodhur fatkeqësia.

Ky Komision, po ashtu, obligohet të raportojë me shkrim para Qeverisë së Kosovës dhe Kuvendit të Kosovës, sa herë që ndodh ndonjë incidentet.

22

## Qeveria ndan edhe 452.681 euro nga fondi rezervë

Qeveria ka vazhduar t'u përgjigjet kërkesave për ndarjen e mjeteve nga fondi "rezervat e paparashikuara të Qeverisë".

Sipas Buxhetit të Kosovës për vitin 2009, për fondin "rezervat e paparashikuara" janë ndarë 5 milionë euro. Nga kjo shumë, Qeveria e Kosovës ka ndarë mjete të shumta duke u përgjigjur kërkesave të kohëpaskohshme për ndarjen e mjeteve financiare për organizata të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare.

Që nga janari 2009, Qeveria e Kosovës përmes 18 vendimeve të ndryshme, ka ndarë 1.814.938 euro nga ky fond. Vetëm në qershor janë marrë tetë vendime për ndarjen e mjeteve nga ky fond, që së bashku kapin shumën prej 438.990 euro.

Më poshtë, mund të kuptoni më shumë për këto vendime.

Mbi 200 mijë euro nga rezervat e Qeverisë për pjesëtarët e ish UÇK-së.

Qeveria e Kosovës, gjatë qershorit të këtij viti, ka vazhduar me ndarjen e mjeteve për të ndihmuar invalidët e luftës dhe ish luftëtarët e UÇK-së.

Ndërkohë që nuk ka ndonjë program të veçantë për të ndihmuar ish pjesëtarët e lëvizjes çlirimtare, zyrtarë të Qeverisë kanë deklaruar se ekzekutivi i vendit është duke u munduar që të përmbushë të gjitha kërkesat e ish pjesëtarëve të UÇK-së dhe të familjarëve të tyre për ndihmë.

Me një vendim të mbledhjes së 19 qershorit, Qeveria ka vendosur që të ndajë mjete në vlerë prej 200 mijë eurosh, me qëllim të mbulimit të shpenzimeve për rehabilitimin e

1000 invalidëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në bregdetin shqiptar. 150 mijë euro për këtë qëllim janë siguruar nga "rezervat e paparashikuara" të Qeverisë, ndërsa 50 mijë euro nga buxheti i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe janë derdhur në xhirrologarinë e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së.

Qeveria, po ashtu, ka ndarë 8.500 euro për të ndihmuar familjen e dëshmorit të UÇK-së, Bekim Mani.

Ndërkohë që zyrtarët e Qeverisë kanë deklaruar se nuk janë duke i kursyer mjetet për të ndihmuar pjesëtarët e lëvizjes çlirimtare, muaji i fundit në Kosovë është karakterizuar edhe me revoltën e veteranëve të ish UÇK-së për mosimplementimin e Ligjit për Vlerat e Luftës.

## 22.490 euro i ndahen Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës.

Me kërkesë të Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, Qeveria e Kosovës ia ka ndarë asaj 22.490 euro. Këto mjete do të shfrytëzohen për trajtimin e rreth 100 familjarëve të personave të zhdukur, të cilët kanë nevojë për trajtim psiko-terapeutik.

Sipas QKRMT, mjetet e ndara në Qeveri ende nuk i janë dorëzuar në konto kësaj organizata dhe nuk kanë marrë ndonjë njoftim zyrtar për këtë çështje.

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) është organizatë joqeveritare, joprofitabile, e themeluar në vitin 1999, me mision të ofrojë trajtim dhe rehabilitim

për viktimat e torturës. Sipas përfaqësuesve të kësaj organizate, numri total i pacienteve që trajtohen aty, në vit, arrin në 500. Për veprimtarinë e kësaj qendre më detajisht mund të informoheni në: [www.krct.org](http://www.krct.org).

## 30.000 € për luftimin e rriqrave.

Me nxehtjen e motit, për çdo stinë të verës, Komuna e Malishevës përballet me rrezikun e pickimit të rriqrave, që jo rrallëherë është shoqëruar edhe me viktima.

Kryetari aktual i Komunës së Malishevës, Isni Kilaj, në fushatën paraelektorale kishte premtuar se në fokus të tij të punës dyvjeçare si do të jetë eliminimi i këtij problemi një herë e përgjithmonë, i cili është gjithnjë më i theksuar në Komunën e Malishevës.

Edhe pse gjatë vitit 2008 kishte një rënie të rasteve të paraqitura nga

pickimi i rriqrave, prapë ky problem vazhdon ta përcjellë këtë Komunë edhe gjatë kësaj vere të 2009.

Për dezinfektimin dhe dezinsektimin e ambientit, Qeveria e Kosovës, nga fondi "rezervat e paparashikuara" ia ka ndarë Komunës së Malishevës 30.000 euro. Mirëpo, në Komunën e Malishevës janë shprehur se këto mjete të Qeverisë nuk janë të mjaftueshme për të përmbyllur me sukses dhe në tërësi procesin e dezinfektimit dhe deinsketimit të ambientit.

Gjithashtu, 150.000 euro i janë ndarë "Trepçës", 8.500 euro një familjeje skamnore nga fshati Kishnicë i Komunës së Prishtinës, 19.500 euro i janë ndarë Zyrës së Kryetarit të Komunës së Shtërpçës, si dhe 13.691 euro i janë ndarë Institutit të Historisë për organizimin e simpoziumit për nder të dhjetëvjetorit të çlirimit të vendit.

Për të lexuar të gjithë numrat e publikimet e tjera të Institutit GAP, na vizitoni në faqen:

[www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)

Prej tani, mbi zbatueshmërinë e vendimeve të muajve të kaluar, do të mund të lexoni në webfaqen e Institutit GAP [www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)







- 3.6 Vendimi 07/69 - Për Miratimin e Strategjisë dhe Planit Nacional të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve në Republikën e Kosovës 2009 – 2013.
- 3.7 Vendimi 08/69 - Për Miratimin e Strategjisë Shtetërore e Republikës së Kosovës Kundër Terrorizimit dhe Planit të Veprimit.
- 3.8 Vendimi 09/69 - Për Miratimin e Strategjisë Shtetërore e Republikës së Kosovës Kundër Drogave dhe Plani i Veprimit.
- 3.9 Vendimi 10/69 - Për Miratimin e Projektligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetikë.
- 3.10 Vendimi 11/69 - Për Miratimin, me ndryshime, të Projektligjit për Mbrojtjen e Topografisë së Qarqeve të Integruara.
- 3.11 Vendimi 12/69 - Zyrës për Çështje të Komuniteteve, në Zyrën e Kryeministrit, i jepet mbështetje të nënshkruajë memorandumin e mirëkuptimit me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Akademinë për Zhvillimin e Arsimit (AED), lidhur me “Programin për Nismën e Ndryshimeve Pozitive”, financiar nga USAID-i.
- 3.12 Vendimi 13/69 - Për Ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 8.500 (tetë mijë e pesëqind) euro për familjen e dëshmorit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Bekim Mani.
- 3.13 Vendimi 14/69 - Për Ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 8.500 (tetë mijë e pesëqind) euro për familjen Krasniqi nga fshati Kishnicë, Komuna e Prishtinës.
- 3.14 Vendimi 15/69 - Për Miratimin e kërkesës të Ministrisë Energjetike dhe Minierave për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) euro, për “Trepça” Sh.A.

**4. Vendimet nga mbledhja e 70 të Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 25 qershor 2009:**

- 4.1 Vendimi 02/70 - Qeveria e Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit të Kosovës kandidatë anëtarët e Bordit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit të Kosovës.
- 4.2 Vendimi 03/70 - Qeveria i propozon Kuvendit të Kosovës që regjistrimi i popullsisë, i ekonomive familjare dhe i banesave, të mbahet nga data 30 mars – 11 prill 2011.
- 4.3 Vendimi 04/70 - Për Miratimin e kërkesës të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për subvencionimin me derivate të naftës për autokombajnata e angazhuara në fushatën e korrje-shirjeve për vitin 2009.
- 4.4 Vendimi 05/70 - Për Miratimin e Strategjisë Zhvillimore e Agjencisë Kadastrale të Kosovës 2009-2011, Planin e Biznesit për Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe Sektorin Kadastral në Kosovë 2009-2014.
- 4.5 Vendimi 06/70 - Ndahen mjete financiare në vlerë prej 22.490 (njëzet e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë) euro, sipas kërkesës së Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës.
- 4.6 Vendimi 07/70 - Ndahen mjete financiare në vlerë prej 30.000 (tridhjetë mijë) euro për dezinfektimin e ambientit të infektuar nga rriqrat.
- 4.7 Vendimi 08/70 - Qeveria e Republikës së Kosovës shfuqizon vendimet paraprake të Qeverisë nr. 07/274, të datës 03.10.2007, vendimin nr. 09/277 të datës 31.10.2007 dhe 15/24 të datës 12.6.2008, lidhur me ndërtimet private brenda hapësirës së QKUK-së, dhe përkrah aktvendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës, Departamenti për Ndërtim 05 nr. 351-19192, të datës 03.09.2007.

nr. 6, qershor 2009

gap

monitor

i vendimeve të Qeverisë së Kosovës

e enjte

e premte

e shtunë

e diel

3

4

5

6

9

10

11

12

13

16

17

18

19

20

shtator 2009

GAP Monitor është publikim i përmuajshëm i Institutit për Studime të Avancuara GAP. Ky numër është përgatitur nga: Agron Demi, agron@institutigap.org; Rudina Heroi, rudina@institutigap.org; Antigona Berisha, antigona@institutigap.org; Visar Berisha, visar@institutigap.org; Ilir Bajraktari dhe Kreshnik Berisha, keka@institutigap.org.

Instituti GAP është Think Tank kosovar, që punon në ngushtimin e hendekut në mes qeverisjes dhe qytetarëve të Kosovës, në shërbim të avancimit të shoqërisë kosovare.

Rr. Nëna Terezë 41/29, 10000 Prishtinë, Kosovë | +381 38 224 145  
monitor@institutigap.org | www.institutigap.org

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA

